# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 18

**Tiranë – E hënë, 12 shkurt 2018**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr. 1/2018 datë 25.1.2018 | Për një ndryshim në ligjin nr. 7651, datë 21.12.1992, "Për festat zyrtare e ditët përkujtimore", të ndryshuar | 673 |
| Ligj nr. 2/2018 datë 25.1.2018 | Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 57/2014, "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Ekonomik Kombëtar" | 673 |
| Ligj nr. 3/2018 datë 25.1.2018 | Për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si administrator i fondeve grant, të siguruara nga qeveri të ndryshme, nën Fondin e Përbashkët Europian të Ballkanit Perëndimor, për projektin e detajuar të linjës hekurudhore Durrës–Tiranë dhe vlerësimin financiar/ekonomik të të gjithë rrjetit hekurudhor në Shqipëri, të ratifikuar me ligjin nr. 63/2015 | 674 |
| Dekret i Presidentit nr. 10724, datë 7.2.2018 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare | 675 |
| Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 38, datë 6.2.2018 | Për delegim kompetencash | 675 |
| Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 6.2.2018 | Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 1966, datë 26.9.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 1861, datë 15.5.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; nr. 00-2017-633, datë 4.5.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.<br>Dhënien e një shpërblimi të drejtë për zgjatje të procesit gjyqësor tej afatit të arsyeshëm dhe ligjor, në bazë të nenit 71/ç, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar | 676 |

Urdhër i drejtorit
të Përgjithshëm të Arkivave
nr. 77, datë 9.2.2018 Për delegim kompetencash..... 682

**LIGJ**
**Nr. 1/2018**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 7651, DATË 21.12.1992, "PËR FESTAT ZYRTARE E DITËT PËRKUJTIMORE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7651, datë 21.12.1992, "Për festat zyrtare e ditët përkujtimore", të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 1, shkronja b/1 ndryshohet si më poshtë:

"b/1) 5 shtatori - Dita e Shenjtërimit të Shenjt Terezës".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.1.2018

**Shpallur me dekretin nr. 10719, datë 6.2.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta**

**LIGJ**
**Nr. 2/2018**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 57/2014, "PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT EKONOMIK KOMBËTAR"**

Në mbështetje të neneve 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 57/2014, "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Ekonomik Kombëtar", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj fjalët "ministria përgjegjëse për ekonominë" zëvendësohen me fjalët "ministria përgjegjëse", ndërsa fjalët "ministri përgjegjës për ekonominë" zëvendësohen me fjalët "ministri përgjegjës".

Neni 2

Në nenin 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

"Mënyra e organizimit dhe funksionimit të sekretariatit teknik përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.".

2. Në pikën 4, në fjalinë e parë, pas fjalëve "Kryetari i Këshillit Ekonomik Kombëtar" shtohen fjalët ", me propozim të ministrit përgjegjës".

3. Në pikën 5, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

"Struktura organizative e sekretariatit teknik miratohet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës.".

4. Pika 6 shfuqizohet.

Neni 3

Pas nenit 9 shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 9/1
**Institucioni përgjegjës**

Institucioni përgjegjës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 4
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.1.2018

**Shpallur me dekretin nr. 10720, datë 6.2.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta**

**LIGJ**
**Nr. 3/2018**

**PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT TË MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, SI ADMINISTRATOR I FONDEVE GRANT, TË SIGURUARA NGA QEVERI TË NDRYSHME, NËN FONDIN E PËRBASHKËT EUROPIAN TË BALLKANIT PERËNDIMOR, PËR PROJEKTIN E DETAJUAR TË LINJËS HEKURUDHORE DURRËS–TIRANË DHE VLERËSIMIN FINANCIAR/EKONOMIK TË TË GJITHË RRJETIT HEKURUDHOR NË SHQIPËRI, TË RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 63/2015**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi i marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si administrator i fondeve grant, të siguruara nga qeveri të ndryshme, nën Fondin e Përbashkët Europian të Ballkanit Perëndimor, për projektin e detajuar të linjës hekurudhore Durrës–Tiranë dhe vlerësimin financiar/ekonomik të të gjithë rrjetit hekurudhor në Shqipëri, të ratifikuar me ligjin nr. 63/2015, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.1.2018

**Shpallur me dekretin nr. 10721, datë 6.2.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta**

**MARRËVESHJE NDRYSHIMI**
TË MARRËVSHJES SË GRANTIT TË DATËS 13 MARS 2015

Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave "Marrësi" dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim "Banka" apo "BERZH-i", si administrues i fondeve të grantit të dhëna nga qeveri të ndryshme, nën fondin e përbashkët të vendeve evropiane të Ballkanit Perëndimor, për projektin e detajuar të linjës hekurudhore Durrës–Tiranë dhe vlerësimin financiar/ekonomik të të gjithë rrjetit hekurudhor shqiptar.

Kjo Marrëveshje Ndryshimi e datës 7.4.2017 lidhet ndërmjet:

1. Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (Marrësi); dhe
2. Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim "Banka" ose "BERZH-i".

Meqë Përfituesi dhe BERZH-i lidhën Marrëveshjen e Grantit në datën 13 mars 2015 (Marrëveshja Fillestare e Grantit), në vijim të së cilës BERZH-i ra dakord të vërë në dispozicion fonde në shumën 1,103,000.00 euro, si grant (Granti) për të financuar shërbimet e konsulencës së një Konsulenti për projektin e detajuar të Linjës Hekurudhore Durrës–Tiranë dhe vlerësimin financiar/ekonomik të të gjithë Rrjetit Hekurudhor Shqiptar.

Me anë të letrës së datës 21 korrik 2016, Marrësi i kërkoi BERZH-it të japë financim shtesë në shumën 112,000 euro për shërbime konsulence shtesë, me qëllim përgatitjen e koncept-projektit për seksionin hekurudhor Terminali i Transportit Publik Tiranë (TTP) - Stacioni i Trenit Tiranë.

Bazuar në sa më sipër, palët kanë rënë dakord të ndryshojnë pjesët e mëposhtme të Marrëveshjes Origjinale të Grantit, si më poshtë:

Neni 1
**Përkufizime**

Përcaktimi i shumës maksimale të Kontratës do të ndryshojë si më poshtë:

"Shuma maksimale e Kontratës" nënkupton shumën maksimale deri në 1,215,000.00 euro, që i paguhet Konsulentit në bazë të Kontratës së Konsulencës, ku përfshihen të gjitha tarifat, dietat dhe shpenzimet.".

Neni 2
**Granti**

Shuma e Grantit ndryshon nga "1,103,000 euro" në "1,215,000 euro".

Në dëshmi të kësaj, palët, me anë të përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje Ndryshimi, në dy kopje, në gjuhën angleze. Kjo Marrëveshje Ndryshimi hyn në fuqi ditën kur Marrësi njofton BERZH-in për përfundimin e procedurave të brendshme të miratimit.

Për dhe në emër të Marrësit:
Këshilli i Ministrave i Republikës
i përfaqësuar nga Ministria e Financave
_____
Emri: Arben Ahmetaj
Ministër i Financave
Datë 7.4.2017

Për dhe në emër të Bankës Evropiane
për Rindërtim dhe Zhvillim
_____
Steve Gillard
Drejtor i Asociuar
Drejtues i Operacioneve TC
Bashkëpunimi Teknik
Datë 25.11.2016

**DEKRET**
**Nr. 10724, datë 7.2.2018**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Nijazi Ibrahim Kryeziu
2. Sami Milazim Lushtaku
3. Feride Milazim Lushtaku (Murseli)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
**Ilir Meta**

**URDHËR**
**Nr. 38, datë 6.2.2018**

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 28 e 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Z. Ergys Qirici, drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronës Publike, i delegoj kompetencën për të nënshkruar korrespodencën me ZRPP-në qendrore dhe degët vendore, Agjencinë e Trajtimit të Pronave, degët e shoqërive publike në qarqe, prefekturat, administratorët dhe likuidatorët e shoqërive me kapital shtetëror, brenda objektit të veprimtarisë së punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Pronës Publike.
2. Data e fillimit të kompetencave të deleguara është data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
3. Çdo akt tjetër që bie ndesh me këtë urdhër shfuqizohet.
4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
**Arben Ahmetaj**

**VENDIM**
**Nr. 3, datë 6.2.2018**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**
**SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Bashkim Dedja | kryetar i Gjykatës Kushtetuese | | |
| Vitore Tusha | anëtare e | “ | “ |
| Fatmir Hoxha | anëtar i | “ | “ |
| Gani Dizdari | anëtar i | “ | “ |
| Besnik Imeraj | anëtar i | “ | “ |
| Fatos Lulo | anëtar i | “ | “ |
| Altina Xhoxhaj | anëtare e | “ | “ |

me sekretare Belma Lleshi, në datën 19.12.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 60/4 Akti, që u përket:

KËRKUES: Ymer Dollani

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Elbasan

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 1966, datë 26.9.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 1861, datë 15.5.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; nr. 00-2017-633, datë 4.5.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Dhënia e një shpërblimi të drejtë për zgjatje të procesit gjyqësor tej afatit të arsyeshëm dhe ligjor, në bazë të nenit 71/ç, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, pikat 1 dhe 2, 15/1, 18, pikat 1 dhe 2, 42, 44, 52/2, 116/b, 122, pikat 1 dhe 2, 131/1, shkronjat “a” dhe “f”, 132, pikat 1 dhe 2, 134, pikat 1/i dhe 2, 141/2 dhe 155, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 45, 49/3/e, 50/4, 71/a, 71/ç dhe 80/1, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Altina Xhoxhaj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi Ymer Dollani ka qenë në detyrën e punonjësit të Policisë së Shtetit dhe ka dalë në rezervë në datën 30.12.2004, për shkak të reformës. Kërkuesi rezulton se është trajtuar me pension të parakohshëm sipas ligjit nr. 8661, datë 18.9.2000, “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit” dhe me vendimin nr. 11, datë 7.2.2008, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Elbasan, atij i është caktuar pension në masën fillestare 39.610 lekë në muaj dhe me të drejtë pagese që prej datës 1.1.2008. Nga data 1.7.2009, DRSSH-ja Elbasan ka bërë rillogaritjen e pensionit për kërkuesin, duke e ulur atë në masën 18.892 lekë dhe e ka deklaruar debitor për shkak të përfitimit të mëparshëm në masë më të madhe se sa pensioni i llogaritur në bazë të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 10142/2009*). Duke mos qenë dakord me këtë vendi, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi, me objekt detyrimin e DRSSH-së Elbasan që të anulojë vendimin e rillogaritjes së pensionit me të gjitha efektet e tij, të paguajë pensionin në masën 43.254 lekë që nga data 1.7.2009, si dhe të paguajë diferencat e papaguara së bashku me kamatëvonesat që prej kësaj date.

2. Me vendimin nr. 1966, datë 26.9.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

3. Me vendimin nr. 1861, datë 15.5.2014, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm. Kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

4. Me vendimin nr. 00-2017-633, datë 4.5.2017, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur me arsyetimin se shkaqet që ngrihen në rekurs nuk janë nga ato që parashikon neni 58, i ligjit nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

II

5. ***Kërkuesi Ymer Dollani*** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

5.1. Vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk respektojnë hierarkinë e rendit juridik, duke i cenuar kërkuesit të drejtën e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, në përputhje me nenin 16, të ligjit nr. 7496, datë 3.7.1991, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe nenin 89, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, "Për Policinë e Shtetit". E drejta për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi është një e drejtë e garantuar nga neni 52/2 i Kushtetutës. Dispozitat ligjore në fuqi i kanë njohur dhe garantuar kërkuesit të drejtën e përfitimit të pensionit të parakohshëm në masën 50% të pagës referuese dhe për çdo vit shërbimi mbi 15 vjet ajo shtohet me 2%, por pa kaluar kjo shtesë masën e pensionit maksimal në shkallë vendi. Pra, në përfundim kërkuesi duhet të përfitojë një pension në masën 39.610 lekë, që i garantohet deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të pleqërisë. Në kundërshtim me parimin e hierarkisë së akteve, gjykatat e të tria shkallëve të gjykimit e kanë zvogëluar masën e pensionit të parakohshëm që duhet të përfitonte kërkuesi.

5.2. Përderisa ligji nr. 9749, datë 4.6.2007, "Për Policinë e Shtetit" në nenin 89 të tij urdhëron që punonjësi i policisë gëzon të drejtën e përfitimeve të tjera shtesë, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 8661, datë 18.9.2000, "Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit", ai e ka kushtëzuar përfitimin e pensionit të parakohshëm në kushtet e përcaktuara vetëm nga ky ligj dhe jo me atë të ndonjë ligji tjetër. Për rrjedhojë, nenet 13 dhe 14, të ligjit nr. 10142/2009, nuk janë dispozitat nga ka buruar e drejta e kërkuesit, pasi sipas nenit 2/2 të tij përjashtohen përfituesit që kanë përfituar pension të parakohshëm para datës së hyrjes në fuqi të ligjit, siç është ky rast. Gjithashtu, rillogaritja e parashikuar nga neni 29/2, i ligjit nr. 10142/2009, nuk mund të bëhet jashtë kontekstit të vendimit nr. 33, datë 24.6.2010, të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka theksuar se kjo rillogaritje do të bëhet vetëm nëse ndryshon pozitivisht situatën e përfituesve. Këto vendime cenojnë edhe parimin e pritshmërive të ligjshme, në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

5.3. Pavarësisht shkeljeve të evidentuara gjatë procesit, Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar rekursin, me arsyetimin se nuk ka shkaqe nga ato që parashikon neni 58, i ligjit nr. 49/2012.

5.4. Gjykata, në çështje të ngjashme, e ka zgjidhur konfliktin mbi bazën e ligjeve që kanë qenë në fuqi në kohën në të cilën palës i ka lindur e drejta për përfitim pensioni të parakohshëm. Po ashtu, këtyre lloj çështjeve u është dhënë përgjigje nga Gjykata Kushtetuese, e cila nuk ka pranuar në vendimin nr. 33, datë 24.6.2010 zvogëlimin e masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe i ka bërë një interpretim pajtues nenit 29 të ligjit. Duke mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me çështje të njëjta është cenuar edhe parimi i barazisë para ligjit.

5.5. Çështja është gjykuar jashtë një afati të arsyeshëm ligjor. Kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 15.2.2013 dhe është mbyllur përfundimisht në datën 4.5.2017, kur është shqyrtuar në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Ligji nr. 49/2012 ka parashikuar një afat 90-ditor për t'u shqyrtuar çështja në Gjykatën e Lartë, ndërkohë që gjykimi në atë gjykatë ka zgjatur për rreth 3 vjet (çështja në atë gjykatë është regjistruar në datën 4.9.2014).

6. *Subjektet e interesuara, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Elbasan*, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës kanë prapësuar sa vijon:

6.1. Kërkesa e paraqitur në Gjykatën Kushtetuese nuk është e mbështetur në prova dhe në ligj, duke iu referuar ligjit material, vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 24.11.2016, si dhe frymës së vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 18.2.2013. Në nenin 29, të ligjit nr. 10142/2009, është parashikuar se pensionet e caktuara në përputhje me ligjin nr. 8661, datë 18.9.2000, "Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit", do të rillogariten, përfshirë edhe ato të caktuara me vendim gjykate. Pra, në këtë dispozitë përcaktohet shprehimisht detyrimi i DRSSH-së për të bërë përllogaritjen e re të pensioneve, në bazë të kritereve të vendosura nga ligji.

6.2. Pas shfuqizimit të dispozitave të ligjit nr. 10142/2009 nga Gjykata Kushtetuese, u miratuar akti normativ nr. 5/2010, i cili ndryshoi konceptin pagë referuese në pagë neto. Ky akt plotësoi vakumin e krijuar dhe me të drejtë DRSSH-ja i është referuar përmbajtjes së tij. Akti normativ është kontrolluar edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila e ka vlerësuar të pajtueshëm me Kushtetutën. Për rrjedhojë, përfitimi i kërkuesit do t'u nënshtrohet përllogaritjeve sipas dispozitave të këtyre akteve ligjore.

## III
## Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

*Për legjitimimin e kërkuesit*

7. Gjykata vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i, të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 71/a, pika 1/b, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e tij janë të tilla që *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues.

*B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike dhe të të drejtave të fituara*

8. Sipas kërkuesit, vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk respektojnë hierarkinë e rendit juridik, duke i cenuar atij të drejtën e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, në përputhje me nenin 16, të ligjit nr. 7496, datë 3.7.1991, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe nenin 89, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, "Për Policinë e Shtetit". Përderisa sipas këtij të fundit punonjësi i policisë gëzon të drejtën e përfitimeve të tjera shtesë, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 8661, datë 18.9.2000, "Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit", ai e ka kushtëzuar përfitimin e pensionit të parakohshëm në kushtet e përcaktuara vetëm nga ky ligj dhe jo me atë të ndonjë ligji tjetër. Po ashtu, kërkuesi pretendon se rillogaritja e parashikuar nga neni 29/2, i ligjit nr. 10142/2009, nuk mund të bëhet jashtë kontekstit të vendimit nr. 33, datë 24.6.2010, të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka theksuar se kjo rillogaritje do të bëhet vetëm nëse ndryshon pozitivisht situatën e përfituesve.

9. Gjykata ka theksuar se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, është një nga parimet themelore në shtetin e së drejtës. Jurisprudenca kushtetuese, konceptin e sigurisë juridike të të drejtave të fituara dhe të pritshmërive të ligjshme, i referon te parimi i shtetit të së drejtës. Parimi i sigurisë juridike përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme (*shih vendimin nr. 20, datë 15.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Parimi i sigurisë juridike përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik *(shih vendimin nr. 25, datë 28.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket të drejtave të fituara si element i këtij parimi, Gjykata është

shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të "procesit të rregullt", përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara (*shih vendimin nr. 10, datë 13.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata vëren se me miratimin e ligjit nr. 10142/2009 u shfuqizua, mes të tjerash, edhe baza ligjore mbi të cilën kishte përfituar kërkuesi. Neni 14, i ligjit nr. 10142/2009, rregullonte masën e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, neni 27 parashikonte kategorinë e ushtarakëve që nuk përfitonin nga ky ligj, ndërsa neni 29, i ligjit parashikonte mënyrën se si do të kryhej rillogaritja e të drejtave të njohura. Këto dispozita u kundërshtuan në Gjykatën Kushtetuese, e cila, me vendimin nr. 33, datë 24.6.2010, vendosi shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të neneve 14/2 dhe 27, të këtij ligji, me arsyetimin se binin ndesh me parimin e sigurisë juridike. Në lidhje me atë pjesë të kërkesës që i referohej nenit 29, të ligjit, Gjykata, bazuar në metodën e interpretimit pajtues, vlerësoi: "*Qëllimi i dispozitave të nenit 29 të ligjit objekt gjykimi, duke u nisur nga konteksti i saj, si dhe konteksti i përgjithshëm i këtij ligji, është që kjo rillogaritje e këtyre të drejtave të fituara në zbatim të ligjeve të mëparshme ose dhe të vendimeve të gjykatave, do të bëhet vetëm në rast se ndryshon pozitivisht, pra përmirëson situatën e përfituesve. Në asnjë rast nuk lejohet që të kryhet një rillogaritje që do të çonte në përkeqësimin e situatës pozitive ose në cenimin e të drejtave të fituara. Në rast të kundërt, pra nëse do të bëhej një interpretim dhe zbatim ndryshe i kësaj dispozite, atëherë do të ishim përpara cenimit të parimit të sigurisë juridike.*".

11. Gjykata vëren se pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi u miratua akti normativ nr. 5, datë 10.11.2010 (i miratuar me ligjin nr. 10367, datë 23.12.2010), i cili plotësoi boshllëkun e krijuar nga shfuqizimi i dispozitave të ligjit nr. 10142/2009. Sipas tij, përfitimet llogariteshin në bazë të pagës referuese, e cila ishte paga mujore për gradë ose funksion, dhe shtesave mbi të. Akti normativ ndryshoi nenin 4 të ligjit, duke parashikuar referimin e përllogaritjes te vlera neto e pagës, si edhe ndryshoi pikat 1 dhe 2 të nenit 14, duke parashikuar se pensioni i parakohshëm për personat që plotësojnë kushtet e përfitimit është 1.5 për qind e pagës mesatare referuese mujore neto për çdo vit shërbimi. Edhe akti normativ u kundërshtua në Gjykatën Kushtetuese, e cila, me vendimin nr. 2, datë 18.2.2013, vendosi rrëzimin e kërkesës me arsyetimin se përmbajtja e tij nuk binte ndesh me parimin e sigurisë juridike.

12. Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi Ymer Dollani ka qenë në detyrën e punonjësit të Policisë së Shtetit dhe ka dalë në rezervë në datën 30.12.2004 për shkak të reformës. Ai është trajtuar me pension të parakohshëm sipas ligjit nr. 8661, datë 18.9.2000, "Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit", duke iu caktuar pensioni në masën 39.610 lekë në muaj, me të drejtë pagese që prej datës 1.1.2008. Rezulton, gjithashtu, se nga data 1.7.2009 DRSSH-ja Elbasan ka bërë rillogaritjen e masës së pensionit për kërkuesin, duke e ulur në masën 18.892 lekë, si dhe e ka deklaruar atë debitor për shkak të përfitimit të mëparshëm në një masë më të madhe se sa ajo e llogaritur në bazë të ligjit nr. 10142/2009. Sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan pensioni i kërkuesit është llogaritur fillimisht nga DRSSH-ja në bazë të nenit 12, të ligjit nr. 8661, dhe më pas është rillogaritur në bazë të nenit 14, të ligjit nr. 10142/2009. Gjatë gjykimit, kërkuesi ka pretenduar se rillogaritja e pensionit të tij bie ndesh me standardin kushtetues të sigurisë juridike. Në përgjigje të këtij pretendimi, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se edhe vetë Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 2, datë 18.2.2013, ka theksuar se akti normativ nr. 5, datë 10.11.2010, edhe pse cenon parimin e sigurisë juridike, është bërë për një interes publik dhe duke ruajtur parimin e proporcionalitetit. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka zbatuar nenin 29, të ligjit nr. 10142/2009, duke vlerësuar: "*Nga përmbajtja e neneve 29 dhe 31, të ligjit të sipërcituar rezulton se dispozitat e ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar", të ndryshuar, si dhe pikat 1 e 2 të nenit 35, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të kenë qenë të zbatueshme deri në datën 1.7.2009, datë kjo pas së cilës, sipas përcaktimeve të neneve 29 dhe 31, të ligjit nr. 10142,*

*datë 15.5.2009, marrëdhënia ndërmjet paditësit dhe palës së paditur rezulton të jetë zgjidhur me ligj. Fakti juridik i sipërcituar të shpie në përfundimin se kërkimi i paditësit për vazhdimin e trajtimit të këtij të fundit me pension të parakohshëm për vjetërsi sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 35, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", si dhe sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar" dhe ligjit nr. 8661, datë 18.9.2000, "Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit", të ndryshuar, edhe pas datës 1.7.2009, rezulton të jetë i pabazuar në ligj, në kushtet kur sipas përcaktimeve të neneve 29 dhe 31, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, marrëdhëniet e ndërtuara ndërmjet përfituesve të pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi me DRSSH-në do të rishikoheshin.*". Të njëjtin qëndrim rezulton se ka mbajtur edhe Gjykata e Apelit Durrës në arsyetimin e vendimit të saj, kurse Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk përmban shkaqe ligjore.

13. Gjykata ka theksuar se një nga detyrimet që kanë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është edhe zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë dhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues; ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit (*shih vendimin nr. 15, datë 10.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të cilat janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit, që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimin nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhej të kishte vlerësuar bazueshmërinë e shkaqeve të ngritura në rekurs dhe të jepte në përfundim një vendim të arsyetuar në lidhje me këto pretendime. Vetëm në këtë mënyrë do të garantohej e drejta e kërkuesit për akses efektiv në gjykatë dhe, lidhur me të, edhe e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, sipas standardeve të vendosura tashmë nga jurisprudenca kushtetuese. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë ngre dyshime në lidhje me respektimin e së drejtës së kërkuesit për një proces të rregullt ligjor.

*C. Për pretendimin e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm*

15. Sipas kërkuesit, çështja është gjykuar jashtë një afati të arsyeshëm ligjor. Kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 15.2.2013 dhe është mbyllur përfundimisht në datën 4.5.2017, kur është shqyrtuar në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Ligji nr. 49/2012 ka parashikuar një afat 90-ditor për të shqyrtuar çështjen në Gjykatën e Lartë, ndërkohë që gjykimi në atë gjykatë ka zgjatur për rreth 3 vjet (çështja në atë gjykatë është regjistruar në datën 4.9.2014).

16. Kërkesat për konstatimin e cenimit për shkak të mosgjykimit apo mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, brenda një afati të arsyeshëm, në jurisprudencën e Gjykatës janë trajtuar në këndvështrim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Gjykata ka vlerësuar se në bazë të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës individi legjitimohet për të pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor edhe në këtë drejtim, për shkak se legjislacioni nuk parashikon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Rezulton se me ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 (të cilat kanë hyrë

në fuqi në datën 5.11.2017) është përcaktuar se çfarë do të konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2), çfarë do të konsiderohet shpërblim i drejtë (neni 399/3), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (neni 399/4 dhe 399/6), rregullat për gjykimin e kërkesës (nenet 399/7) etj. Për rrjedhojë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore efektive, me qëllim që individit t'i garantohet mbrojtja efektive në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm apo edhe për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm. Megjithatë, në rastin konkret rezulton se kërkesa jo vetëm që është paraqitur në Gjykatë në datën 31.8.2017, pra përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, por edhe se procesi gjyqësor tashmë ka përfunduar në të tria shkallët e gjykimit dhe, në këtë kuptim, kërkuesi nuk ka mjet tjetër efektiv, përveçse kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

18. Në lidhje me thelbin e këtij pretendimi, Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu dhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, neni 3 i ligjit nr. 49/2012, ndër parimet e gjykimit administrativ, ka përcaktuar sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit në krijimin e këtyre gjykatave. Në këtë kuptim, ligji nr. 49/2012 ka parashikuar afate të mirëpërcaktuara për gjykimin në shkallë të parë (neni 25 për veprimet përgatitore, neni 27 për caktimin e seancës gjyqësore), për gjykimin në apel (neni 48/2 për shqyrtimin e çështjes nga gjykata e apelit), si dhe për gjykimin në Gjykatën e Lartë (neni 60/2 në shqyrtim) (*shih vendimin nr. 26, datë 27.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në qëndrim të konsoliduar në lidhje me gjykimin e çështjeve të së njëjtës natyrë, Gjykata ka theksuar se përderisa ligjvënësi ka përcaktuar këto afate kohore (90 ditë në rastin në fjalë), do të thotë se ai i ka konsideruar ato si afate të arsyeshme për t'u zbatuar nga gjykatat administrative. Në këtë drejtim, respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta. Po në këtë këndvështrim, Gjykata ka vlerësuar se justifikimet, se shkak i vonesës në shqyrtimin e çështjes është numri i lartë i çështjeve në ngarkim të këtyre gjykatave, nuk janë të bazuara. Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Në të kundërt është detyrë e këtij të fundit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatë të Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimin nr. 26, datë 27.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Për sa më sipër, procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë ngre dyshime edhe në lidhje me respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të standardit të shqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

21. Gjykata vëren se në objekt të kërkesës, kërkuesi ka pretenduar edhe shpërblimin e drejtë për shkak të mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, duke iu referuar si bazë ligjore nenit 71/ç, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Kjo dispozitë i referohet tejzgjatjes së procesit para Gjykatës Kushtetuese, ndërkohë që, në rastin konkret, pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në këto kushte, në lidhje me kërkesën për dëmshpërblim për tejzgjatje të procesit gjyqësor, kërkuesi duhet t'u drejtohet gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në kuptim të dispozitave procedurale të sipërcituara.

22. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, nga ana e Kolegjit

Administrativ të Gjykatës së Lartë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2017-633, datë 4.5.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Altina Xhoxhaj.

**URDHËR**
**Nr. 77, datë 9.2.2018**

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat", të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Endrit Musaj, drejtor i Inspektimit dhe Trajnimeve, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.
2. Kompetencat e drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 12.2.2018 deri në datën 16.2.2018.
3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve, dhe do t'ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.
5. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve, z. Endrit Musaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
**Ardit Bido**

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004  Tel.:  +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë